



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 3020 Prot.

Tirane, me 09.05 2016

DEKLARATE MJEDISORE

per Vleresimin Strategjik Mjedisor

Ne mbështetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, miraton kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Integruar Ndersektorial i Bregdetit

Kerkuesi: Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit

Kufijte e zones qe mbulon plani: te gjitha bashkite qe preken nga brezi bregdetar (Shkodra, Lezha, Kurbini, Durresi, Kavaja, Rrogozhina, Divjaka, Fieri, Vlora, Himara, Saranda dhe Konispoli)

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrisë:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Plani do te siguroje zhvillimin e qendrueshem te turizmit bregdetar, duke mundesuar perdorim te balancuar te resurseve pergjate vijes bregdetare me shtrirje veri- jug. Per çeshtje te lehtesise se menaxhimit te procesit, brezi bregdetar do te menaxhohet ne 4 nenzona, sipas tipareve te ngjashme territoriale, por vizioni i zhvillimit dhe politikat e hartimit te Planit Ndersektorial i Turizmit Bregdetar do te jene nje „mbulese“ e vetme per te gjithë brezin bregdetar, dhe ceshte me e rendesishme, do te jene te integruara me vizionin dhe politikat e Planit te Pergjithshem Kombetar.

Zona 1: Velipoje – Derdhja e Lumit Mati

Zona 2: Derdhja e Lumit Mat – Derdhja e Lumit Shkumbin

Zona 3: Derdhja e Lumit Shkumbin – Derdhja e Lumit Vjose

Zona 4: Derdhja e Lumit Vjose – Butrint

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-se dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve perkatese.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit

Gjate zbatimit të veprimeve, priten të ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë si pasoje permiresim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastruktures në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka vecori të theksuara të ndryshme dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje të gjera dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgimie kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, vecanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Perputhshmeria e me objektivat mjedisore të projekteve specifike individuale:

- Të gjitha projektet specifike që lidhen me sektorin e Infrastruktures kanë një përqindje të konsiderueshme përputhshmerie të pjesshme apo të kushtëzuar, për shkak të ndikimeve që priten të shkaktojnë, dhe që kërkojnë zbatimin e masave perkatese zbutëse.
- Përsa i përket dy projekteve të sektorit të Ekonomisë, njëri prej tyre, PE1 është plotësisht në përputhje me objektivat mjedisore, ndërsa projekti i dytë, PE2 ka një përqindje të konsiderueshme përputhshmerie të pjesshme dhe të kushtëzuar, për shkak të ndikimeve që priten të shkaktojnë, dhe që kërkojnë zbatimin e masave perkatese zbutëse.
- Të dy Projektet që lidhen me sektorin e Mjedisit janë në përputhshmeri të plote me objektivat mjedisore.

Ndikimet kumulative të projekteve që parashikon të zhvillojë Plani do të japin rezultat pozitiv në raport me Objektivat Mjedisore, lidhur me Zonat e Mbrojtura dhe Biokorridoret, në rast se krahas zbatimit me prioritet të Legjislacionit Mjedisor dhe “best practices” nderkombetare do të

aplikohen masat zbutese efektive dhe te integruara me mjedisin. Ne asnje rast projektet dhe nuk duhet te nderhyjne ne territorin e zonave te mbrojtura (sidomos Parqet Kombetare), sic parashikon edhe Plani. Persa i takon investimeve qe krijojne impakt ne zonat e mbrojtura dhe per me teper kur ato ndodhen brenda tyre (HEC-et, bujqesia intensive, turizmi, transporti, etj.) duhet te aplikohet me prioritet legjislativ per zonat e mbrojtura, i cili i ndalon ato.

Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjithe fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te planit mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte efciente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukurore te parashikuara ne Plan sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri, dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Plani duhet te nxite realizimin e projekteve te impianteve te trajtimit te ujrave te perdorur urbane dhe ne nje shkalle me te gjere duke e shtrire kete mase edhe ne aktivite e tjera industriale qe krijojne shkarkime ujrash industriale te ndotura dhe qe ndikojne sidomos ne cilesine e ujrave siperfaqesore, nentokesore dhe te ujrave bregdetare. Te projektohet infrastrukture bashkekohore dhe afatgjate te kanalizimeve te ujerave te ndotura urbane.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Masat e aktiviteve te Planit duhet te perfshijne krijimin e kalimeve te pershtatshme per kafshet e egra nese fragmentet ekzistuese provojne se jane te papershtatshme apo te pakalueshme.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te aktiviteve specifike individuale te Planit duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore.
- Plani te marre masa per promovimin e transportit publik te pasagjereve dhe transportin hekurudhor kargo qe te kontribuojne ne pakesimin e shkarkimeve ne ajer.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te

zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve në mbrojtje. Promovimi brenda dhe në periferitë e zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbeshtesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë. Nderkohe që Plani zhvillon konceptin mbi rrjetin kombëtar të rrugëve automobilistike dhe bicikletave, të përshpejtohen zhvillimet e ngjashme dhe zbatimi brenda rrjetit lokal urban duke aplikuar „best practices“ ndaj përmirësimit të cilësive së ajrit dhe efekteve negative/ndotese nga zhurma.

- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Plani duhet të jetë me konservator në raport me ceshtjet e menaxhimit dhe cilësive së ujërave si sasi dhe cilësi, përfshirë edhe akuiferet. Projektet që kanë të bëjnë me përdorim të ujërave të konsiderohen me kondicione kufizuese mjedisore për aq kohë sa pasigurite dhe irreversibiliteti është i lartë.
- Masat në lidhje me monitorimin e ujërave si dhe aplikimi i masave adaptuese kundrejt përmblytjeve dhe ngritjes së nivelit të detit duhet të ndërthuren që në fazat e hershme të projektimit. Keto masa janë efektive kur aplikohen të integruara në pëllgun ujembledhës të lumenjve dhe bregdetit. Masat në lidhje me monitorimin e ujërave si dhe aplikimi i masave adaptuese kundrejt përmblytjeve dhe ngritjes së nivelit të detit duhet të ndërthuren që në fazat e hershme të projektimit. Keto masa janë efektive kur aplikohen të integruara në pëllgun ujembledhës të lumenjve dhe bregdetit si dhe duhet të integrohen në një masë me të gjere brenda Planit si përgjate gjithë bregdetit Shqiptar ashtu edhe në vecanti për zonat me të ndjeshme/vulnerable të zonës veriore (Buna – Kepi i Rodonit)
- Elementi i impaktit të mbetjeve të parashikuara kërkon të trajtohet qysh herët në zhvillimin e masave, në mënyrë integrale, ndërsektoriale dhe në lidhje me menaxhimin e tokës. Keto sisteme duhet të përfshijnë 3 R-të (Riciklimi, Ripërdorimi, Reduktimi) si pjesë e suksesshme të zbatimit në praktike.
- Plani duhet të parashikojë kapacitete me të mëdha për landfillet ekzistuese dhe se pari ndertimi i landfilleve të reja teknologjike duhet të paraprijë investimet në këtë sektor dhe të koordinohen në kohë sipas rajoneve perkatëse ku do të ndodhin zhvillimet (se pari në zonën bregdetare dhe në qendrat primare të zhvillimit në çdo rajon).
- Të planifikohen dhe projektohen në mënyrë strategjike elementet e administrimit të mbetjeve. (impiante riciklimi, landfille etj).
- Të projektohen elementet urbane të administrimit të mbetjeve (si vendi ku do të vendosen koshat e mbetjeve, koshat e vegjël të rrugëve etj).
- Për fillimit të zbatimit të projekteve të zgjidhet ceshtja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Në teresi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësive së mjedisit të jenë përsore duke aplikuar „best practices“.

Detvrimet dhe sanksionet:

- › Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;

- › Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklaratë Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivlerësimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-së fillon nga e para.
- › Në rast se ministria, strukturat e saj, njesitë e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëherë ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimit të planit dhe, sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit deri në sqarimin e situatës.
- › Nëse pasojat në mjedis të shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoritetit miratues të propozues të marrin masa të duhura apo të konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.
- › Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklaratë Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore.



Lefter KOKA

MINISTRI

Zona ne studim



Lista e grup-projekteve te Planit

Sektori	Projekti	Kodi*
Infrastruktura	- Ndertimi i terminalit te trageteve ne portin e Sarandes	PI1
	- Ndertimi i portit te jahteve (marina) ne Porto Palermo	PI2
	- Ndertimi i terminalit te autobuzeve per segmentin verior ne Vellopoje	PI3
	- Projekt pilot per integrimin e zonave rurale dhe atyre te thella	PI4
	- Hekurudha Tirane – Durres – Aeroport i Rinasit	PI5
Ekonomia	- Krijimi i klasterave turistike (Porto Palermo, Himare)	PE1
	- Krijimi i nje qendre shendetesore / SPA ne Lagunen e Nartes	PE2
Mjedisi	- Krijimi i korridorit te gjelber per Lumin e Ishmit	PM1
	- Park rajonal prane Shkodres	PM2